

Malësia – Ëndërr e së Kaluarës, apo Barrierë për të Ardhmen

Shkruan:
Faton H. Bislimi

Boston, SHBA
9 Dhjetor 2005

Edhe pse angazhimi në çështjen kombëtare shqiptare ka qenë, është, dhe do të jetë një nga prioritetet e mia, duhet pranuar se deri në fillim të Gushtit 2003, as unë, sikur as shumë atdhetarë tjerë në SHBA, nuk ka patur një vizion mjaft të qartë për gjendjen e shqiptarëve në Republikën e Malit të Zi. Keqkonceptimi i gjendjes së tyre besoj se zakonisht është krijuar nga verërat e bujshme. Shqiptarët e Kosovës zakonisht pushimet e tyre verore i bëjnë në plazhat maxhepse të Ulqinit dhe me siguri gjatë pushimit veror ata nuk e lodhin kokën me politikë. Në të njëjtën kohë, as nikoqirët e tyre ulqinakë nuk kanë fort lëvërdi të merren me problemet kombëtare me të cilat ata ballafaqohen nën tutelën e Podgoricës pasi që duhet të merren me sigurimin e sa më shumë turistëve që të sigurojnë sa më shumë të ardhura verore përmes së cilave duhet mandej ta mbijetojnë edhe dimrin.

Mirëpo, cka është më e rëndësishme është vet fakti se jo vetëm Ulqini është tokë shqiptare në Mal të Zi. Njerzit shpeshëherë harrojnë se territori stërgjyshor shqiptar në Mal të Zi është shumë më i madh se vetëm Ulqini, e ende më i rëndësishëm është fakti se popullata jo-ulqinake shqiptare e Malit të Zi gjithashtu është shumë më e madhe se vetëm ajo ulqinake.

Shkurt thënë kjo është **Malësia**, është Plava e Gucia, është Kraja, e Anamali, Tuzi, etj. Dhe, kur përmenden këto vendbanime të gjithë ata që ndonjëherë kanë mësuar

histori shqiptare me doemos do thonë: “Ohh, po, po, edhe këto vise janë shqiptare.” Por fati i tyre dita e ditës për errësohet, fatkeqësisht. Malësia - gjysh, stërgjysh, e katragjysh – ka qenë e banuar me shqiptarë – den baba den. Ajo ka qenë vatër e shqiptarisë në këtë pjesë të territorit shqiptar në Ballkan. Ajo ka qenë po ashtu edhe vatër e rezistencës kombëtare ndaj pushtimeve sllave për dekada me rradhë. Dhe, falë trimërisë, bujarisë shqiptare, dhe vendosmërisë për të ruajtur identitetin e tyre kombëtar, Malësorët edhe sot janë po ata Malësoret e kohës së Skënderbeut, të Ismail Qemalit, e Isa Boletinit. Sot, janë po ata malësorë për sa i përket traditës, dokeve, e zakoneve të shqiptarisë, ndërsa për sa i përket kapacitetit njerëzor e intelektual, dihet se edhe pse gjithmonë të shtypur, malësorët përsëri kanë arritur që të avancohen në cdo aspekt. Në ndihmë të avancimit të tyre dhe trojeve shqiptare në Malësi gjithëherë është gjetur e pakursyer mërgata malësore në SHBA si dhe vendet tjera perëndimore.

Dhe, unë do të mund të vazhdoja e të shkruaja jo vetëm një artikull, por një libër, apo një volum librash për Malësinë në përgjithësi – për historinë e saj, për të tashmën, e për të ardhmën – mirëpo, përsëri do t’i kthehem përvojës sime personale me këtë vatër shqiptare. Përsëri po i kthehem Gushtit 2003.

Ishte fundi i Korrikut 2003, dhe isha duke përfaqësuar Kosovën në Konferencën Ndërkombëtare të Liderëve të Rinj në Pragë, kur nga ish-kongresisti amerikan Joe DioGuardi kisha marrë kërkesën që t’i bashkangjitesha delegacionit të Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane në vizitën e tij së bashku me Kongresistin e squar Amerikan, z. Tom Lantos dhe bashkëshortën e tij në trojet shqiptare në Mal të Zi. Isha i gëzuar për këtë nder, dhe në të njëjtën kohë i shqetësuar në anticipim të asaj që do të shihja. Për të qenë krejtësisht i sinqertë, Malësia për mua ka qenë vetëm një nocion historik. Për këtë arsye, kisha ndërpre vizitën në Pragë më herët dhe kasha udhëtuar menjëherë për në Prishtinë e po të njëjtën ditë menjëherë për në Ulqin ku do të bëhesha pjesë e këtij delegacioni historik. Dhe, ishte kjo koha – tri ditët më të rëndësishme të vitit 2003, tri ditët e para të Gushtit – që kthyen nocionin historik që kisha për Malësinë në një realitet të qartë. Por çfarë ishte ky realitet?

Të them se isha i maxhepsur nga ajo që kisha pare, është e vërtetë. Por në të njëjtën kohë, të them se isha i shokuar dhe thellë i tronditur në zemër, gjithashtu është e vërtetë. Ajo që më maxhepsi ishte bukuria natyrore e Malësisë – malet, fushat, e luginat që aq shumë përfolën në historinë tonë kombëtare. Bukuria natyrore e këtij rajoni më kishte befasuar për së miri. Ndërkohë, që isha shokuar e tronditur thellësisht nga kushtet e jetesës, nga diskriminimi i hapur dhe shtetësisht i orkestruar kundrejtë malësorëve shqiptarë. Isha tronditur sepse si shqiptar që jam kurrë nuk kisha ditur për shkallën e lartë të diskriminimit me të cilin ballafaqoheshin shqiptarët e këtij rajoni. Dhe jo vetëm mua, por besoj se gjithësecilin shqiptar të vërtetë një realitet i tillë i hidhur duhet ta trondisë. Dhe, qysh atëherë kam bërë gjithëcka që kam mundur që të paktën ta arsimojë vetën time më shumë në lidhje me këtë çështje.

Në këtë drejtim, gjithëherë kam mbetur i angazhuar me ata që më së shumti kanë punuar për të sjellur drejtësi për shqiptarët në Mal të Zi, në Malësi e Ulqin – me Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane, dhe disa nga malësoret më të denjë e më bujarë që ndonjëherë kam takuar që tani jetojnë në Amerikë, por punojnë ditë e natë edhe për atdheun e tyre, Malësinë shqiptare. Kështu, duke i përcjellur zhvillimet e fundit në këtë truall shqiptar, jam detyruar që t'i vëjë në letër këta rreshta. Jam detyruar që të them publikisht atë që besoj se duhet thënë nga të gjithë ata që besojnë në barazi kombëtare, në dinjtet njerëzor, në barazi qytetare, në demokraci të mirëfilltë, dhe në liri.

Se shtytja kryesore për të gjithë shqiptarët intelektualë e aktivistë për të reaguuar dhe për t'u angazhuar edhe më shumë tani se ndonjëherë më pare për drejtësi në Malësi është fakti i miratimit të Ligjit për Kryeqytetin nga Parlamenti Malazias pak kohë më parë. Një prej kërkesave kryesore të shqiptarëve të Malësisë ka qenë dhënia, apo më mirë thënë, rikthimi i statusit të komunës për Tuzin si kryeqendër e Malësisë. Vetëm kështu, shqiptarët e Malësisë do të kishin të paktën pak mundësi më të madhe për të arritur të gëzojnë të drejtat e tyre themelore kombëtare të paktën në nivelin komunal.

Sot, edhepse Mali i Zi zyrtarisht propagandon se është vend demokratik ku të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta, ai në të vërtetë ende bën diskriminin të

skajshëm dhe tepër perfid ndaj shqiptarëve. Dhe, të gjithë këtë ani edhe po e legjitimon përmes ligjeve që definitivisht shkojnë në dëm të aspiratave shqiptare për të jetuar të barabartë në këtë republikë. Ata nuk duan, e as nuk kërkojnë asgjë më shumë se çfarë u takon si qytetarë të Malit të Zi.

Duke patur parasysh faktin se Qeveria Malaziase ka qenë nën presion të vazhdueshëm nga lobi shqiptar në SHBA (LQSHA), e vecanërisht nga nënkryetari i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Kongresit të SHBA-ve, z. Tom Lantos, e anëtarëve të tjerë të këtij komiteti të rendësishëm në Kongres, si Kongresisti Dana Rohrabacher, etj, është me të vërtetë të habitesh se Podgorica merrë guximin dhe aprovon një ligj kundër të cilit janë malësorët dhe përkrahësit e drejtësisë ndërkombëtare në Capitol Hill. Edhe këtu, duhet gjetur ceslin që i mundësoi Podgoricës të merrë një vendim të tillë. Dhe, nuk duhet ndonjë analizë shkencore apo astronomike për të parë se fatkeqësisht këtë cels Podgorica e gjeti tek vet shqiptarët. Ishte vota e një deputeti shqiptar që më në fund i dha shumicën detyrimit të nevojshme për aprovimin e këtij ligji. Ligj ky, i cili e bënë Tuzin piun-komunë, apo servil-komunë të Podgoricës dhe asgjë më shumë. E në të njëjtën kohë, përjashton cdo reagim të malësorëve dhe cdo kërkesë të tyre legjitime për vetadministrim lokal.

Është tejet e cuditshme që Podgorica ndërmerrë hapa të tillë që definitivisht mohojnë të drejtën elementare qytetare të malësorëve për të vetadministruar në mënyrë domethënëse në nivel komunal, kur bashkësia ndërkombëtare kërcen lartë e poshtë në kurriz të Prishtinës zyrtare që të bëjë gjithëcka që është e mundur përmes të ashtuquajturit “decentralizim” që t’iu sigurojë sa më shumë kompetenca në vetadministrim komunal serbëve të Kosovës. Atëherë, si është e mundur që gjerësa mbi Prishtinën të insistohet për “decentralizim” dhe për më shumë vetadministrim për lokalitetet serbe, duke krijuar kështu bile edhe komuna të reja për serbët, gjerësa mbi Podgoricën kush nuk qanë kokën?! Por, këtë shqiptarët duhet ta bëjnë të ditur përmes cdo forme tek krerët e Bashkësisë Evropiane, dhe të vazhdojnë të marrin përkrahjen e Washingtonit.

Ajo se çfarë thuhet në Washington e Bruksel për Prodigoricen do të luajë rol tejet të rëndësishëm në aspiratën e saj për pavarësi. Shqiptarët janë një forcë që Podgoricës mund t'ia rëndojnë shumë rrugën drejtë pavarësisë. Se a fitojnë apo jo dic shqiptarët nga një Mal i Zi i pavarur varet nga fakti se sa shqiptarët arrijnë që në agjendën e prioriteteve të Podgoricës të vendosin plotësimin e të drejtave të tyre qytetare dhe kombëtare gjithënjë nën mbiqyrjen dhe insistimin ndërkombëtar. Këtë punë deri më tani me shumë sukses e ka bërë Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane nën lidërsipin e ish-kongresistit Joe DioGuardi dhe znj. Shirley Cloyes, në bashkëpunim të ngushtë me shumë malësorë që tani janë mërgimtarë në SHBA, sic janë Marash Nucullaj (Detroit) e Gjergj Dedvukaj (New York). Kontributet që kanë dhënë atdhetarët si Nucullaj e Dedvukaj e shumë malësorë të tjerë janë shtylla kryesore e suksesit në influencimin pozitiv të figurave më të rëndësishme të politikës së jashtme amerikane në Kongres për të punuar për të drejtat e shqiptarëve në Mal të Zi dhe për të kundërshtuar zyrtarisht edhe hapur Podgoricën në denoncimin e saj ndaj diskriminimit kundër shqiptarëve.

Fatkeqësisht, një betejë për të cilën malësorët luftuan gjatë – për rikthimin e statusit të komunës për Tuzin – paraqet edhe një prej çështjeve kryesore që detyrimisht duhet zgjidhur drejtë. Miratimi në Parlamentin Malazias të Ligjit për Kryeqytetin paraqet vetëm edhe një arsye më shumë për punë më të madhe dhe angazhim më serioz. Ndërkohë, kjo çështje, po ashtu paraqet edhe një fakt të pakëndshëm për të cilin shqiptarët e Malësisë dhe të të gjitha viseve në Mal të Zi duhet menduar mirë – kënd duhet apo nuk duhet votuar për të arritur deri në pozitë vendimmarrëse shtetërore nga rradhët e shqiptarëve; kush është ai që i mbron apo vetëm pretendon se i mbron interesat qytetare të shqiptarëve në Mal të Zi?

Sidoqoftë, beteja për realimin e të drejtave të shqiptarëve në Mal të Zi nuk ka marrë fund. Ajo vetëm ka hyrë në një fazë më të nxehtë. Tani, jo vetëm malësorët si Nucullaj e Dedvukaj e shokët e tyre, por të gjithë shqiptarët e Malit të Zi që jetojnë në SHBA, dhe në përgjithësi të gjithë shqiptarët nga të gjitha trojet shqiptare që gjenden këtu, duhet bashkuar forcat si intelektuale ashtu edhe materiale që përmes celsit shqiptar në Capitol Hill, pëmres shqiptaro-amerikanit më të suksesshëm në politikën amerikane,

ish-Kongresistit Joe Dioguardi, përmes luftëtarës intelektuale të paepur për çështjen kombëtare shqiptare znj. Shirley Cloyes, dhe Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane si dhe organizatave tjera të komuniteteve shqiptare nëpër SHBA, të bëjnë që miqtë tanë në Kongresin e SHBA-ve t'i vëhen edhe më agresivisht në kurriz Podgoricës duke insistuar se Washingtoni nuk do të njehë një Mal të Zi të pavarur përgjërësa ky shtet nuk i plotëson kriteret ndërkombëtare të të drejtave qytetare dhe kombëtare të një pakice autoktonte, sic janë shqiptarët atje.

Malësoret dhe gjithë shqiptarët në Mal të Zi duke i koordinuar veprimet e tyre diplomatiko-politike, dhe duke bërë një kampanjë të fuqishme ndërkombëtare për të ekspozuar njëherë e përgjithëmonë diksriminin në baza kombëtare që ndodhë në shtetin e Malit të Zi nën tutelën e Podgoricës hipokrike që para komunitetit ndërkombëtar paraqitet sikur engjëll, gjersa në brendësi është në të vërtetë djallë. Shqiptarët fatmirësisht nuk po kërkojnë asgjë më shumë se sa u takon atyre – barazi qytetare e kombëtare, liri, dhe të drejta të barabarta në cdo sferë të jetës. Sot për sot Malësia paraqet një barrierë të madhe për të ardhmen e Podgoricës, dhe vetëm përmes garantimit të të drejtave të tyre dhe ndryshimit të casjes së politikës së Podgoricës zyrtare ndaj shqiptarëve – duke i parë ata si element kyc në mbijetesën e shtetit, e jo si grup inferior – Mali i Zi do të bëhet me të vërtetë një shtet demokratik dhe Malësia nuk do të mbetet vetëm ëndërr e së kaluarës apo nocion historik i historisë kombëtare shqiptare, historisë së popullit më të vjetër në Ballkan, por do të bëhet një rajon me prosperitet për bashkëjetesë dhe zhvillim social e ekonomik.

Autori është duke magjistruar në Administratë Publike dhe Marrëdhënie (Zhvillim) Ndërkombëtare në Shkollën Postdiplomike të Qeverisjes John F. Kennedy të Universitetit të Harvardit në Cambridge, SHBA. Ai është nderuar me tillutin më prestigjioz për kandidatët e magjistraturës Kennedy Fellow të kësaj shkolle me renome botërore.

Ju lutem mos hezitoni që komentet tuaja në lidhje me këtë publikim t'i dërgoni përmes faqës sonë në internet (nën rubrikën “Komentet”). Komentet tuaja janë gjithëherë të mireseardhura.

The Bislimi Group

www.bislimi.org